

## KOMUNA SHTIME

### DREJTORIA E PROKURIMIT

Nr. 03 / 1 / 084

Datë 26 / 10 / 2022

### KONTRATË PUNE

Numri i kontratës: 617 22 10119 5 2 1/C460

Komuna Shtime, Rr "Tahir Sinani", tel 0290 389 016 228 ose 045 444 509 që e përfaqëson Muhadin Halili, Udhoheqës i Zyres së Prokurimit në njëren anë;

dhe

N.T.P. ,, Ardhmëria ,, emri tregtar ,, Dashnim Jashari BI ,, emri i biznesit ,, Rr., Tahir Sinani ,, Shtime ,, që e përfaqëson z. Dashnim Jashari Drejtor tel. 044-228-437 në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

#### **Rregullimi i Parkut në Fshatin Petrovë-Komuna Shtime**

Me numër identifikues: 617-22-10119-5-2-1

#### **Neni 1 Lënda**

Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

#### **Rregullimi i Parkut në Fshatin Petrovë-Komuna Shtime**

#### **Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 32,227.60 €;( tre/dy/dy/dy/shtatë/gjashtë/zero)

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve

2.3 Pagosat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

#### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës; Po

Kushtet e Veçanta të Kontratës; Po

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës; Po

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike; PO

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);Po

Sigurimi i Ekzekutimit Po

Plani Dinamik PO

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### **Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetimin të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Kontraktuesin

<b>Emri:</b>	Muhadin Halili	<b>Emri:</b>	Dashnim Jashari
<b>Pozita:</b>	Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit	<b>Pozita:</b>	Drejtor
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	26.10.2022	<b>Data:</b>	26.10.2022
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

## KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 617-22-10119-5-2-1/C460

### **Neni 1 Përkufizimet**

1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 “Punë” konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre

1.3 “Kontraktuesi” është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 “Menaxheri i Projektit” është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës ( apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqytjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 “Çmimi Kontratës” do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 “Vendi i ndërtimit” do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 “Pajisjet e kontraktuesit” do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 “Skicat” nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 “KPK” do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “KVK” do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### **Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm**

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përrekon të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### **Neni 3 Transferimi**

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

#### **Neni 4 Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë të Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

### **OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES**

#### **Neni 5 Dhënia e dokumenteve**

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare,

Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

## **Neni 6 Qasja në vend punishte**

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

## **Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore**

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

## **OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT**

### **Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit**

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimin për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime

të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpallë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: okskavatorë të llojve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

## **Neni 9 Personeli**

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

## **Neni 10 Siguria e ekzekutimit**

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

## **Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit**

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindese për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbresë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

## **Neni 12 Programi**

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnojë programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rrisë detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punëve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

## **Neni 13 Siguria në vend-punishte**

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë,

skermën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues

#### **Neni 14 Ndërhyrja me trafikun**

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit

#### **Neni 15 Tatimi**

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

#### **Neni 16 Kostoja e Riparimeve**

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

### **FILLIMI DHE VONESAT**

#### **Neni 17 Fillimi i punëve**

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

#### **Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritët se do të vonohet, për ndonjëherë nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;

b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

## **Neni 19 Dëmet e likuiduara**

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

## **MATERIALET DHE MJESHTËRTIË**

### **Neni 20 Regjistri i punës**

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne Kontraktuesit;

deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afërta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marr një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

## **Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve**

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet ti referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues së plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në punë.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në punë ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkuorporim në punë vetëm nëse janë riparuar.

## **Neni 22 Inspektimi dhe testimi**

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "*Menaxherin e Projektit*", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rena dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për të lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do të lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të

Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

### **Neni 23      Paralajmërim i hershëm**

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato ne skica apo ne specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët ne kontrate vlerësojnë se ndërrimet substanciale te punëve janë bere te nevojshme për shkak te gabimeve te tilla ose te përjashtimeve te cilat substancialisht ndikojnë ne çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do te korrigjojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit te Prokurimin Publik.

## **PAGESAT**

### **Neni 24      Pagesa**

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do te rregullohen per zbritje per pagesat paradhënie dhe te mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

### **Neni 25      Paramasa dhe Paralogaria**

25.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve qe duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

### **Neni 26      Parapagimi**

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një

Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

#### **Neni 27        Mbajtja e Parasë**

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë parate të mbajtura me garancion bankar "me kerkese".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

#### **Neni 28        Vërtetimet e pagesës**

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a) Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b) Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim

#### **Neni 29        Llogaritja përfundimtare**

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet të paguhet sipas kontratës; dhe

- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

### **Neni 30 Shkaqet për kompensim**

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend udhëtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

### **PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFJEKTET**

#### **Neni 31 Parimet e përgjithshme**

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

#### **Neni 32 Testet për përfundimin**

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 33      Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilit, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

### **Neni 34      Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshëm i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërtimi apo rinovimi.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i

projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

### **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cukur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jetë dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

## **SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA**

### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dënimeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkolje të kontratës për rasto të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tjetër krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkakuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Pala do t'i bejne te gjitha perpjekjet per te zgjidhur ne menyre miqesore te gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të

arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 43      Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 617-22-10119-5-2-1/C460

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante].*

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Igji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Igjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
Siguria e ekzekutimit	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe
	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është <b>10% e vlerës së kontratës për periudhën deri më 31.10.2023 pastaj do të nënshkruhet kontrata .</b>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve</li> <li>2. humbje ose dëmtim i Pajisjeve</li> <li>3. humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve)</li> <li>4. dëmtim personal ose vdekje:               <ol style="list-style-type: none"> <li>(i) të punëtorëve të Kontraktuesit</li> <li>(ii) të personave të tjerë</li> </ol> </li> </ol> <p><b>Përgjegjësi mbanë kontraktuesi (OE)</b></p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim programin për punët brenda <i>tri</i> ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
Fillimi i punëve	17.1	<b>Data e fillimit do të jetë: 31.10.2022</b>
	17.2	<b>Data e përfundimit e të gjitha punëve do të jetë 25.09.2023</b>
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <b>0.25 %</b> për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është <b>10%</b> e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	OE është i obliguar të mbaj regjistër të punës, dhe dokumentacionin tjetër të nevojshem.

Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i projektit emrohet nga ZKA.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N/A
Mënyra e Pagesave	30.1	<p><b>Pagesa do të bëhet si në vijim:</b></p> <p><b>Pagesa në shumë prej 11,530.00 euro do të bëhet nga buxheti i vitit 2022 në bazë të situatave të punëve të realizuara ,(Çertifikatave) të verifikuara nga Menaxheri i kontratës. Ndërsa shuma prej 20,697.60 euro, do të bëhet nga buxheti i vitit 2023</b></p> <p>OE duhet të sjellë këto dokumente për pagesën e fundit :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Garancioni për punët o kryera për( 12 muaj )</li> <li>2.Raporti i pranimit teknik nga komisioni.</li> <li>3.Situacioni përfundimtar .</li> <li>4.Fatura e rregullt.</li> <li>5.Raporti nga mbikqyrësi për përfundimin e punëve me plan dinamik</li> </ol>
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	OE,është i obliguar të sjellë një garancion bankar ose nga kompania e sigurimit të vlerës së 10% të kontratës për periudhen 12 mujore nga data e pranimit teknik të projektit.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve .AK do të bëjë pagesën e punëve të përfunduara , të vërtetuara nga menaxheri i kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>Palet kontraktuese do të bëjnë përpjekje për ti zgjidhur mosmarrëveshjet eventuale , përmes mirëbesimit ose negociatave miqësore .</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet lënda në gjykatën Kompetente .

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA**  
**PARKU NË PETROVE - SHTIME**



Vërejtje	<i>Të gjitha pozicionet e projektit përfshijnë, blerjen, furnizimin me material, transportin, shkarkimin si dhe vurjen në vepër të materialeve për secilin pozicion.</i>
	<i>Furnizimin me ujë dhe energji elektrike (për ekzekutimin e projektit) operatori ekonomik e bën zgjidhjen me shpenzime vetanake komfor rregullave të kompanive të KEDS-it dhe ujesjellësit. Hudhja e mbeturinave bëhet në depon që e përcakton organi mbikqyrës.</i>

<b>A ARKITEKTURA</b>		Njësia	Sasia	çmimi	Shuma
I	<b>Punët përgatitore</b>				
1.1	Gjetja, evidentimi, matja dhe ruajtja e pikave gjeodezike, sipas projektit: shënimi i projektit/parkut në bazë të parametrave gjeometrik.	komplet	1.0	€ 50.00	50.00 €
1.2	Të bëhet pastrimi i terrenit prej këtyre materialeve të cilat konsiderohen pengesa për zhvillimin e punimeve, si: heqja e shkurreve, hjekja e gurëve, materialeve të forta, betoneve dhe gjitha mbeturinave që ndodhen në sipërfaqe të terrenit të parkut. Njëherit materiali i grumbulluar parashihet të dërgohet/transportohet deri në deponi, sipas Menagjerit të kontratës, (largësia në rreze deri në 5km).	komplet	1.0	€ 50.00	50.00 €
<b>Shuma 1</b>					<b>100.00 €</b>

2	<b>Punët e Gërmimit dhe nivelizimit</b>				
Vërejtje	<i>Gjatë gërmimit të terrenit të parapar për park, duhet të ket kujdes në formimin e pjerrtësive të sipërfaqeve të parapara me projekt. Sipërfaqja e fushës sportive, e këndit të lojrave dhe e pingpongut duhet të ket sipërfaqe të rrafshët.</i>				
2.1	Gërryerja e bazës së parkut dhe gërmimi në sipërfaqet e caktuara për gjelbrim. Duhet të bëhet largimi i materialit, nivelizimi i saj, pra heqja e shtresës së tokës mes.20cm. Dheu i gërryer nëse është kualitativ duhet të planifikohet të shpërndahet mbrenda pozicionit të parkut, nëse për nga kualiteti është i dobët duhet të transportohet deri në deponi, sipas udhëzimeve të menaxherit, (largësia në rreze deri në 5km).	m <sup>3</sup>	230.00	€ 1.20	276.00 €
2.2	Gërryerja dhe gërmimi e terrenit në pjesët: e shtigjeve të këmbësorëve, parkingut, në këto sipërfaqet e cekura gërmimi duhet të bëhet d=30cm. Llogaritet edhe nivelizimi i këtyre sipërfaqeve. Dheu i gërryer duhet të planifikohet të shpërndahet mbrenda pozicionit të parkut, por nëse për nga kualiteti është i dobët duhet të transportohet deri në deponi (largësia në rreze deri në 5km). Sipas udhëzimeve të menaxherit.	m <sup>3</sup>	160.00	€ 1.20	192.00 €
2.3	Furnizimi, transporti, shtruarja, planifikimi dhe kompaktimi i shtresës humusore, i dheut kualitativ, në pjesët e parapara për gjelbrim. Me qëllim të formimit të nivelit të sipërfaqes.	m <sup>3</sup>	230.00	€ 1.50	345.00 €
2.4	Pastrimi i shtratit të lumit komplet nga mbeturinat, materialet e forta, drunjet, shkurret.	m <sup>3</sup>	100.00	€ 10.00	1,000.00 €
2.5	Gërmimi i dheut në shtratit të lumit dhe formimi i shtratit të lumit në baze të detaleve të prejave terthore.	m <sup>3</sup>	100.00	€ 5.00	500.00 €
<b>Shuma 2</b>					<b>€ 2,313.00</b>


3	Punët e mbushjes dhe zhavorit				
Vërejtje	Gjatë shtruarjes së shtresave të zhavorit duhet pasur kujdes në formimin e pjerrtësisë së duhur të sipërfaqes për rrjedhjen e ujërave atmosferike në sipërfaqet gjelbruese. Si dhe sipërfaqja finale me kubëza duhet të jetë në nivel të njëjtë me nivelin e sipërfaqes gjelbruese.				
	OE është obligativ për zhavorin me të cili do të punohet parku, të dorëzohet menaxherit të kontratës (A testi).				
3.1	Furnizimi, transporti, planifikimi dhe ngjeshja e zhavorit me fraksion Ø 0-63mm për punimin e bazamentit të shtigjeve të këmbësorëve, këndit të lojrave, fushës së pingpongut, parkingut, fushave sportive, me trashësi t=20cm në gjendje të ngjeshur. Llogaritet edhe ngjeshja e zhavorit me cilindër. Ngjeshja e zhavorit duhet të bëhet në shtresa.	m <sup>3</sup>	160.00	€ 4.50	720.00 €
3.2	Furnizimi, transporti, planifikimi dhe ngjeshja e zhavorit me fraksion Ø 0-31.5mm për punimin e bazamentit të shtigjeve të këmbësorëve, këndit të lojrave, fushës së pingpongut, parkingut, fushave sportive, me trashësi t=10cm në gjendje të ngjeshur. Llogaritet edhe ngjeshja e zhavorit me cilindër. Ngjeshja e zhavorit duhet të bëhet në shtresa. Ngjeshja te fusha e pingpongut, këndi i lojrave dhe shtigjet e këmbësorëve duhet të arrijë koficientin mbi 500KN/cm <sup>2</sup> .	m <sup>3</sup>	80.00	€ 6.00	480.00 €
3.3	Furnizimi, transporti dhe planifikimi mbi zhavorin e ngjeshur (të shtigjeve të këmbësorëve) i gurit të bluar 4-8mm, me trashësi t=5cm, për vendosjen e kubzave.	m <sup>3</sup>	45.60	€ 8.00	364.80 €
3.4	Furnizimi, transporti, planifikimi i gureve të thyer natyrore, me fraksion Ø200-400mm për punimin e shtratit të lumenjve (në të tri anët: dy ansoret dhe bazamenti). Guret duhet të palohen me dore, duke u krijuar një strukturë lidhëse uniforme në tere shtratit e lumit. Në këtë pozicion të kalkulohet dhe betoni i varfer për lidhjen e gurëve në mes vete.	m <sup>3</sup>	333.00	€ 25.00	8,325.00 €
3.5	OE është obligativ, para shtruarjes së kubzave, duhet ta bëjë (A testin) e ngjeshmërisë (në shtigje të këmbësorëve, në kënd të lojrave, në fushë të pingpongut). Mostrat duhet të merren sipas normave profesionale në prezencë të Menaxherit të Kontratës.	copë	6.00	€ 25.00	150.00 €
<b>Shuma 3</b>				€	<b>10,039.80</b>

4	Kubëzat e betonit				
vërejtje	<i>OE është obligativ për kubëzat dhe skajorët me të cilat shtrohet parku, të dorëzohet menaxherit të kontratës (qertifikatat e bazuara në standarde).</i>				
4.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i skajorëve nga betoni me dimensione 8x20cm, për të dy anët e shtigjeve të këmbësorëve, dhe për rethimin e sipërfaqeve së caktuar për lule. Në këto pozicion të kalkulohet dhe betoni I nevojshem për fiksimin e	m'	400.00	€ 7.50	3,000.00 €
4.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e kubëzave të parafabrikuara nga betoni C-30, në formë drejtkëndëshe, në nunancë të zeze, me trashësi 8cm, për punimin e shtigjeve të këmbësorëve dhe parkun e lodrave si dhe kyqjet nga rruga në park.. Dizajnin e kubëzave e përzgjedh organi mbikqyrës. Në këtë pozicion përfshihet edhe furnizimi, transporti dhe shpërndarja e rërës së imët mbi kubëza për mbushjen e fugave. Pas mbushjes së fugave të shtigjeve të këmbësorëve, duhet të pastrohet dhe të nivelizohet edhe njëherë me makinë vilvuese	m <sup>2</sup>	570.0	€ 8.00	4,560.00 €
				<b>Shuma 4 €</b>	<b>7,560.00</b>


5	Pajisjet sportive dhe mobiluari urban					
Vërejtje	Të gjitha panellet (kallëpet) e pjesëve të dukshme të betonit të lyhen dhe të jenë të kualitetit të lartë në mënyrë që të përmbushen edhe kriteret e larta vizual-estetike të sipërfaqeve të betonuara. Kriteret estetike të përmbushen të gjithat sipërfaqet e dukshme.					
5.1	<p>Furnizimi, transporti dhe punimi i ulëseve nga materiali: drurit dhe hekurit. Në llogari hynë komplet punimi i ulëseve sipas vizatimit, duke përfshi ankerimin e tyre në dyshe, furnizimin dhe punimin e listelave drunore, furnizimin dhe punimin e profileve metalike, të gjitha këto sipas projektit të bashkangjitur, parashihet edhe furnizimi dhe lyerja e ulëseve me material për mbrojtje kundër lagështisë, insekteve, këpurdhëve si dhe lyerje përfundimtare, dhe të gjitha elementeve tjera përcjellëse për fiksion: bulonave, pllakave, etj. Punëkryesi obligohet që para vurjes në vepër të marr aprovimin nga ana e organit mbikëqyrës. Modeli, dizajni i karrikave të jetë në përputhje me dimensionet në detaj skicën.</p> 	copë	13	€	40.00	520.00 €
5.2	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i shportave të mbeturinave. Konstrukti mbajtës i shportave të jetë nga profilet e metalit, ndërsa pjesët tjera konstruktive nga druri. Llogaritet edhe përforcimi i tyre në bazament me ankerë special, pllakë metalike apo me betonim. Modeli të jetë në përputhje me specifikimet në përshkrimin teknik.</p> 	copë	7	€	40.00	280.00 €
5.3	Furnizimi, transporti, prerja, lakimi dhe montimi i shufrave të armaturave për: për themelin dhe këmbët e karrikave ulëse në park. Armatura që do të vendoset do të jetë me profile: Ø8, Ø10, Ø12. Llogaria në kg. Klasa e duktilitetit (ductility class) B-e lartë (high ductility) B 500B.	kg	540.00	€	1.20	648.00 €
				Shuma 5	€	1,448.00

6	Gjelbrimi					
6.1	Furnizimi, transporti dhe mbjellja me farë kualitative në sipërfaqet e parapara për gjelbrim. Si dhe rrafshimi me ngjeshje me cilindër të dorës/kopshtarit prej 50-60 kg.	m <sup>2</sup>	1120.0	€	0.25 €	280.00

6.2	Furnizimi me drunj dekorativ të llojit: "ACER Variegatum" dru gjethërënës. Diametri i trungut 7-8cm. Fidanet duhet të kenë dëshmi për prejardhje (certifikata e origjines). Në çmim llogaritet mirëmbajtja e gjelbrimit të lartë me ujilje, ose rikultivimin e sërishëm nëse mbjelljet dështojnë. Në çmim llogaritet edhe furnizimi me lëndë drurore b/h=3/5 cm dhe punimi i tyre në lartësi prej max. h=1.6m të cilat shërbejnë si mbrojtje për gjelbrimin e lartë.	copë	8	€ 20.00	€ 160.00
6.3	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e drunjëve të llojit: "Druri Japonez-kumbull japoneze", dru gjethërënës me gjethe ovale dhe ngjyrë kumbulle në të kuqe; Diametri i trungut 7-8cm. Në çmim llogaritet mirëmbajtja e gjelbrimit të lartë me ujilje, ose rikultivimin e sërishëm nëse mbjelljet dështojnë. Në çmim llogaritet edhe furnizimi me lëndë drurore b/h=3/5 cm dhe punimi i tyre në lartësi prej max. h=1.6m të cilat shërbejnë si mbrojtje për gjelbrimin e lartë.	copë	11	€ 20.00	€ 220.00

6.4	<p>Furnizimi, transporti dhe mbjellja e drunjëve të flojit: "Bagrema të but". Diametri i trungut 7-8cm. Në çmim llogaritet mirëmbajtja e gjelbrimit të lartë me ujë, ose rikultivimin e sërishëm nëse mbjelljet dështojnë. Në çmim llogaritet edhe furnizimi me lëndë drurore b/h=3/5 cm dhe punimi i tyre në lartësi prej max. h=1.6m të cilat shërbejnë si mbrojtje për gjelbrimin e lartë.</p>	copë	14	€ 20.00	€ 280.00
6.5	<p>Furnizimi, transporti dhe mbjellja e: "Bredhave". Lartësia mesatare h=1,5m. Në çmim llogaritet mirëmbajtja e gjelbrimit të lartë me ujë, ose rikultivimin e sërishëm nëse mbjelljet dështojnë.</p> 	copë	15	€ 12.00	€ 180.00
<b>Shuma 8</b>					€ 1,120.00

7	Ndriçimi					
Vërejtje	<i>Themelet për shtyllat e reflektorëve punohen në të njëjtën kohë gjat punimit të pozicionit të themelit të rrethojës së fushë së sportit. Pozita dhe dimenzionet janë të përshkuara në projekt, fig.1.</i>					
7.1	Hapja e kanalit me dim. B=0.55 h=0.9m, për vendosjen e rrjetit të ndriçimit në park, në kuadër të këtij pozicioni llogaritet edhe hapja e gropave për themelet e trupave ndriçues.	m'	200.0	€	1.00	€ 200.00
7.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e tubit të brinjëzuar PVC Ø63mm për kabllon furnizuese të trupave ndriçues.	m'	200.0	€	3.00	€ 600.00
7.3	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe konektimi i kabllit nëntokësorë PP00/5x2.5mm, Bakër, i standardizuar për instalime nëntokësore.	m'	50.0	€	3.00	€ 150.00
7.4	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe konektimi i kabllit nëntokësorë PP00/3x2.5mm, Bakër, i standardizuar për instalime nëntokësore.	m'	200.0	€	1.00	€ 200.00
7.5	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe konektimi i kabllit PPY/3x1.5mm, Bakër, i standardizuar për instalime nëntokësore dhe për secilin trup ndriçues në park.	m'	69.0	€	1.20	€ 82.80
7.6	Furnizimi dhe shtrirja e shiritit të zinkuar FeZn (25x4)mm për krijimin e rrjetës së përtokëzimit për çdo shtyllë, duke parapartë edhe lëshesat adekuat në gjatësi mesatare 1.5m, pllakat kryqëzuese 60x60x3mm dhe realizimi i përtokëzimit përmes mbërthimit në dadon ekzistuese të shtyllës apo kornizës metalike si dhe lyerja me ngjyrë antikorozive në vendet e salduara të shiritit dhe bufonave shtrëngues.	m'	200.0	€	1.20	€ 240.00
7.7	Furnizimi, transporti dhe shpërndarja e rërës së imët nën kanalit e tubit brinjorë d=10 cm, dhe mbi tubin brinjor mbulimi me rërë d=10 cm, përgjat tërë gjatësisë së kanalit, me qëllim të mbrojtjes së kabllit.	m <sup>3</sup>	38.00	€	8.00	€ 304.00
7.8	Mbulimi dhe ngjeshja e kanalit me dheun e gërmuar duke llogaritur edhe furnizimin, vendosjen e shiritit vrejtuës nga PVC me gjerësi 60mm, përgjatë gjithë trasesë.	m'	200.0	€	0.50	€ 100.00
7.9	Furnizimi, transporti, shtruarja dhe ngjeshja e zhavorit Ø0-31mm me trashësi t=10cm për shputat e themeleve/bazamenteve të trupave ndriçues dhe bazamenteve të shtyllave të reflektorëve.	m <sup>3</sup>	1.00	€	10.00	€ 10.00
7.10	Furnizimi, transporti dhe betonimi i bazamentit/themeleve të veçanta për përforcimin e trupave ndriçues të parkut. Themeli i betonit për trupat ndriçues L=3m duhet të jetë 45x45cm h=60cm, ndërsa për shtyllat e reflektorëve themeli i tyre duhet të punohet 80x80cm h=80cm. Klasa e betonit C25/30. Në këtë pozicion llogaritet edhe furnizimi/punimi i kallëpve dhe largimi i tyre.	m <sup>3</sup>	4.00	€	75.00	€ 300.00
7.11	Furnizimi, transporti dhe montimi i sondave përtokëzuese Fe/Zn; 75/1500mm dhe lëshuarja e sondave në punë.	copë	5	€	15.00	€ 75.00


7.12	<p>Furnizimi, transporti dhe montimi i llampave në park (duke përfshi: trupin/shtyllën e ndriçimit të zinkuar, kokën e trupit ndriçues, poçin elektrik 45W led, si dhe përforcimin e tyre në bazmentet e betonit me 4 ankera (h=25cm), pllakave të çelikut dhe 4 pllakave këndore, (duke llogaritur të gjitha mjetet e nevojshme përcjellëse për këtë pozicion, si dhe material të imët për vuarjen në funksion të trupave ndriçues). Diametri i trupave ndriçues në pikën 0.00 duhet të jetë mes 10cm, ndërsa në pjesën ku fiksohet koka ndriçuese d=7cm. Pozicionet e trupave ndriçues duhet të korrespondojnë me projektin. Modeli i llampave të jetë në përputhje me specifikimet/dizajnin në përshkrimin teknik, lartësia e trupit duhet të jetë mesatare 3.0 m.</p> 	copë	23	€ 200.00	€ 4,600.00
7.13	<p>Porosia dhe montimi i Kuadrantit qendror për furnizimin e ndriçimit publik, me pjesën e gjatit shtesë nga jashtë për leximin e njehsorit, pjesën e zbrazur rezerve të mbrojtur e Dekarpiruar me dim (90x60x30).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërprerës AS-/A 1</li> <li>- Transformatorë rrymorë /5 A 16</li> <li>- Mikrondërprerës /A 1</li> <li>- Portllampë E27 1</li> <li>- Poç fluroshent 1x18w me baze 1</li> <li>- Prizë OG 16 A 1</li> <li>- Voltmetër Vm 0-500 V 1</li> <li>- Ampermetër Am 0-200A 1</li> <li>- Ndërp. Zgjedhës për Am80A-u-R10 1</li> <li>- Ndërprerës tipi GS-16-66 U 1</li> <li>- Sig. Tripolare automatike /A te vendosura në kuti për 3 siguresa komplete 3 ORS siguresa 9 patron/A</li> <li>- Siguresa njëpolare automatike 10-16A 16 copë schneider</li> <li>- Përçues 1x25 mm<sup>2</sup> (m) 50</li> <li>- Kontaktorë tlp CS 160 ose 100A 3</li> <li>- Ndërprerësi automatik/A 1</li> <li>- Rele IC Astro 1</li> </ul> <p>Komplet me shtrëngues dhe material tjetër si dhe skema njëpolëshe e vendosur brenda dhe numri i ormanit i vendosur jashtë si dhe shenja e rrezikut .</p>	cope	1	€ 250.00	€ 250.00
7.14	Furnizimi me kablo kryesore nga shtylla me e afert deri tek ormani i shperndarjes kablo 5x16 mm.	m'	50	€ 10.00	€ 500.00
7.15	Depertimi i asfaltit per kalimin e tubit te brinjezuar per furnizim te rrjetit te ndriçimit me energji elektrike.	m'	6	€ 50.00	€ 300.00
<b>Shuma 7</b>					<b>€ 7,911.80</b>

8	Punët e tjera					
8.1	Furnizimi transporti dhe montimi i kapakut mbi pusetat e ngritura, së bashku me kornizë, kapaku duhet të jetë nga materiali i gizës ose kompozite, me peshë mbajtëse.	copë	4.0	€ 100.00	€	400.00
8.2	Patrimi i pusetave egzistuese të parkut. Dhe funksionalizimi i tyre.	cope	3.0	€ 20.00	€	60.00
8.3	Rrenimi i murit ekzistues nga guret, blloqet dhe tullat me lartësi H=3.0 m. Materiali i demoluar të transportohet në deponi në largësi min. 10km.	m'	15.0	€ 5.00	€	75.00
8.4	Hapja e kanalit me thellësi H=120 cm dhe gjeresi t=80cm për vendosjen e gypave të betonit Ø 400 mm. Pas shtrirjes së gypave të mbulohet kanali me dheun e germuar dhe pjesa e mbetur të transportohet në deponi.	m'	60.0	€ 5.00	€	300.00
8.5	Furnizimi, punimi dhe montimi i gypave të parafabrikuar të betonit fi 400 mm.	m'	60.0	€ 15.00	€	900.00
<b>Shuma i0</b>					€	<b>1,735.00</b>

**REKAPITULLIMI TOTAL**

1	Punët përgatitore	100.00 €
2	Punët e Gërmimit dhe nivelizimit	2,313.00 €
3	Punët e mbushjes dhe zhavorit	10,039.80 €
4	Kubëzat e betonit	7,560.00 €
5	Pajisjet sportive dhe mobiluari urban	1,448.00 €
6	Gjelbrimi	1,120.00 €
7	Ndriçimi	7,911.80 €
8	Punët e tjera	1,735.00 €
<b>TOTALI</b>		<b>32,227.60 €</b>

Emri i Kompanisë	NTP "ARDHMERIA"
Adresa e Plote	SHTIME, rr. "TAHIR SINANI"
Përfaqësuar Nga:	
Emri & Mbiemri	DASHNIM JASTARI
Pozita	DREJTOR
Nënshkrimi	
Data	13/10/2022
Vula	



## ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Përshkruaj specifikimet teknike, në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme të objektit të kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe të operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar të vendosë specifikime teknik që favorizojnë ose dis-favorizojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

2. Nëse variantet lejohen Autoriteti Kontraktues duhet të ceket specifikimet minimale që duhet të përmbushen nga një variant dhe çdo kërkesë specifike për prezantimin e variantit të tillë janë

Përshkrimi	PO/JO
Kualiteti i punës dhe Mallrat duhet të jen të kualitetit të garantuar, dhe të përgjigjet përshkrimeve teknike në parametere	PO
Garancioni kualitetit të jete 12 muaj	PO
Mallrat për punë duhet të përgjigjen standardeve CE	PO
Performancë e punës të përgjigjet kualitetit të standardeve dhe normave ligjore në fuqi	PO
Pajisjet dhe mallrat duhet të përgjigjen Specifikimeve në përshkrim	PO

PAJTOHEM ME TË GJITHA SPECIFIKIMET TEKNIKE NË DOSJEN E TENDERIT SI DHE: : Kualitetin, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Informacionet teknike të dotuara mund të shikohen në gjuhën që zakonisht shfrytëzohet ndërkombëtarisht për teknikën e tillë

VULOS DHE NENSHKRUAJ

NTP "ARDHMERIA"  
13/10/2022





# ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

## Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Policies me Nr. 107846

### Për Komuna Shtime

( Emri i "Autoritetit Kontraktues" )

Në emër të **Dashnim Jashari B.I.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Rregullimi i parkut ne Fshatin Petrove-komuna Shtime**

Nr. prokurimit: 617-22-10119-5-2-1 , Nr. brendshëm: 617-2022-093-521

### Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **3,223.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **3,223.00€** siç është lartëcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 365 ditë kalendarike prej **26.10.2022** deri më **26.10.2023**

Data lëshimit: 26.10.2022

Nënshkrimi dhe vula e garantuosit

Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA SHTIME  
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi  
Uprava za Urbanizam, Katastar i Geodeziju  
Department of Urban Planning, Cadastre and Geodesy

Data/Datum/Date:	26.10.2022
Nr./Br./No	06/94
Për/Za/To:	Drejtorinë e Prokurimit Drejtore, Jeton Raka
Nga/Od/From:	Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Drejtore, Grejtalb Emini
Lënda/Predmet/Subject :	Vendim, për Menaxher të Kontratës dhe mbikëqyrës të drejtpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës

Në bazë të nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 9 paragrafi 1 pika g), si dhe nenit 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, i datës 01.02.2021, dhe Vendimit të ZKA nr. 02/70, të datës 25.03.2022 për autorizim për emërimin e menaxherëve dhe mbikëqyrësve të kontratave. Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi merr këtë:

#### VENDIM

1. Emërohet Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Kontratës për kontratën: *Rregullimi i Parkut në Fshatin Petrovë-Komuna Shtime,*
2. Menaxher i Kontratës: *z. Fatmir Rexhepi -urbanizem*
3. Emërohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës: *z. Grejtalb Emini-Drejtore I Urbanizmit*
4. Menaxheri i kontratës, dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës,

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.  
P'u dorëzohet:

1. Menaxherit të Kontratës;
2. Mbikëqyrësit të Menaxherit të Kontratës;
3. Zyrës së Kryetarit;
4. Drejtorisë së Prokurimit.